



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

# RREGULLA PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGJISË NË KOSOVË

Prishtinë, ..... 2017



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe Nenin 38 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_ [data] miratoi:

## **RREGULLËN PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGJISË NË KOSOVË**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Qëllimi përgjithshëm i kësaj Rregulle është të krijoj një procedure publike, transparente dhe jo-diskriminuese të licencimit, që promovon themelimin e një sektori konkurrues të energjisë, nxit investimet duke siguruar stabilitetin dhe sigurinë e furnizimit me energji në Kosovë.
2. Synimi i kësaj Rregulle është të promovoj zhvillim në sektorin e energjisë përmes:
  - 1.1. kryerjes së aktiviteteve të energjisë në mënyrë transparente, të hapur dhe jodiskriminuese;
  - 1.2. rregullimit të tregut të energjisë në mënyrë të tillë që të siguroj marrëdhënie të paanshme dhe transparente ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve;
  - 1.3. përcaktimit dhe ofrimit të trajtimit të shpejtë, efikas dhe ekonomik të të gjitha çështjeve lidhur me dhënien e licencave;
  - 1.4. krijimit dhe monitorimit të tregut konkurrues, parandalimit dhe ndëshkimit të çdo sjelljeje abuzive apo anti-konkurruese;
  - 1.5. kryerjen transparente dhe jo-diskriminuese të aktiviteteve të energjisë të cilat janë subjekt i obligimeve të shërbimit publik, si dhe duke siguruar qasje jo-diskriminuese në sistemet e transmisionit dhe të shprëndarjes dhe në interkoneksion.
  - 1.6. krijimit të kushteve për shfrytëzimin efikas, me kosto efektive, dhe të sigurt të energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror;
  - 1.7. balancimit në mënyrë të drejtë të interesave të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë;
  - 1.8. mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, sigurisë dhe ambientit.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke zhvilluar të drejtat, obligimet dhe kushtet e licencës, ka për qëllim që të obligoj dhe të stimuloj të Licencuarit që të operojnë në mënyrë që të arrijnë të gjitha objektivat e përshkruara në licencat e tyre.



3. Për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni, ZRRE ka autoritetin dhe përgjegjësinë:
  - 3.1. të lëshoj, të modifikoj, të pezulloj, të transferoj apo të ndërpres licencat;
  - 3.2. të mbikëqyr dhe të kontrolloj pajtueshmërinë me kushtet e licencës;
  - 3.3. të monitoroj shthurjen ligjore, organizative, vendimarrëse dhe të llogarive të ndërmarrjeve për energji dhe të certifikoj operatorët e sistemit të transmisionit;
  - 3.4. të rishikoj, të miratoj dhe të kontrolloj pajtueshmërinë me të gjitha kodet, duke përfshirë Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Kodin e Pajisjeve Elektrike, Kodin e Standardeve Elektrike, Kodin e Matjes, Rregullat e Tregut, dhe kodet tjera teknike dhe komerciale;
  - 3.5. të jap pëlqime për ndarjen, shuarjen ose zvogëlimin e kapitalit fillestar të ndërmarrjeve të licencuara për energji.

## Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **“Aplikues”** - personi fizik apo juridik që aplikon për licencim të aktivitetit të energjisë, në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle dhe kur licenca i lëshohet një shoqërie tregtare të sapokrijuar, do të përfshij kompaninë mëmë ose kompanitë që zotërojnë dhe kontrollojnë shoqërinë e re tregtare.
  - 1.2. **“Palë kontraktuese”** është shtet nënshkruar i traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë;
  - 1.3. **“ZRRE”** - Zyra e Rregullatorit për Energji;
  - 1.4. **“Aktivitete të energjisë”** - ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Energjinë;
  - 1.5. **“Energji”**- çdo formë e gjenerimit të energjisë (energji elektrike, energji termike ose gaz natyror) për qëllim të shitjes ose furnizimit;
  - 1.6. **“Licencë”** - dokumenti i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrijë aktivitete në sektorin e energjisë, për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve në lidhje me sektorin e energjisë; dhe
  - 1.7 **“Ngrohje e përqendruar”** –energji termike që transportohet përmes fluidit-bartës të energjisë termike nga prodhuesi deri tek konsumatori, përmes rrjetit të shpërndarjes, për qëllim të ngrohjes së hapësirave të banimit dhe afariste në nivelin e kërkuar, si dhe ngrohjen e ujit sanitar dhe industrial;
  - 1.8 **“Energji termike”** ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Energjinë Termike;



- 1.9 **“Gaz natyror”**- ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Gazin Natyror;
- 1.10 **Operatori i Sistemit të Depozitimit**- ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Gazin Natyror;
- 1.11 **Stabiliment i Depozitimit**- ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Gazin Natyror;
- 1.12 **“Furnizim”** – sa i përket energjisë elektrike, nëkupton shitjen, duke përfshirë rishtijen e energjisë elektrike **tek konsumatorët me shumicë dhe ata fundor**, në pajtim me Nenin 3.1.17 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Nenin 3.1.15 të Ligjit për Energjinë, ndërsa sa i përket gazit natyror nëkupton shitjen, duke përfshirë rishtijen e gazit natyror tek konsumatorët fundor, siq është përcaktuar në Nenin 3.1.3 të Ligjit për Gazin Natyror.
2. Termet e përdorura në këtë Rregull do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë Termike dhe Ligjin për Gazin Natyror.

### Neni 3 **Aktivitetet e licencuara**

1. Sipas Nenit 28, paragrafi 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, një licencë e lëshuar nga ZRRE mund të mbuloj më shumë se një nga aktivitetet energjetike të mëposhtme:
- 1.1. gjenerimin e energjisë elektrike ose energjisë termike (ngrohjes)
  - 1.2. bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë termike;
  - 1.3. transmetimin e energjisë elektrike ose gazit natyror, përfshirë operimin e sistemit të transmisionit;
  - 1.4. shpërndarjen e energjisë elektrike ose gazit natyror, përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes;
  - 1.5. shpërndarjen e energjisë termike;
  - 1.6. furnizimin e garantuar me energji elektrike;
  - 1.7. deponimin e gazit natyror, përfshirë Operatorin e Sistemit të Depozitimit;
  - 1.8. subjekt i dispozitës në paragrafin 4 më lartë, furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike ose gazit natyror, duke përfshirë transitin, importin ose eksportin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;
  - 1.9. furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike ose gazit natyror;
  - 1.10. operimin e tregut për energji elektrike ose gaz natyror;
2. Aktivitetet e energjisë për të cilat nuk kërkohet licencë:
- 2.1. gjenerimi i energjisë elektrike në lokacion energjetik me kapacitet total që nuk tejkalon 5 MW;
  - 2.2. gjenerimi i energjisë elektrike të prodhuar nga ngruhtoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon fuqinë e instaluar prej 1 MW;



- 2.3. gjenerimi i energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk janë të lidhur në sistemin e transmisionit apo sistemin e shpërndarjes;
- 2.4. depozitimin e gazit natyror ku kapaciteti total i depozitimit nuk tejkalon dhjetëmijë (10.000) metra kub.
3. Për shmangje të ndonjë dyshimi, aktiviteti i transitit të energjisë elektrike osë gazit natyror, sipas Nenit 3, nënparagrafi 1.55 të Ligjit për Energjinë, nuk kërkon lëshimin e një license nga ZRRE.
4. Kur, dhe vetëm deri në masën që, ZRRE është pajtuar në marrëveshje reciproke, sipas kushteve të Nenit 32.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, me autoritetin kombëtar rregullativ të ndonjë pale tjetër kontraktuese, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror i përshkruar në Nenin 1, nënparagrafi 1.8 më lartë, nuk kërkon dhënien e licencës nga ZRRE.

## **KREU II PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LICENCAVE**

### Neni 4

#### **Aplikimi për licencim**

1. Aplikimi për licencim, ndryshim, transferim dhe vazhdim të licencës bëhet me shkrim dhe në formën e specifikuar nga ZRRE duke përfshirë kërkesat e përgjithshme shtesë dhe kërkesat specifike të përshtatshme për secilin lloj të licencës, siq është theksuar në Kreun III të kësaj Rregulle.
2. Aplikuesi duhet të dorëzoj në ZRRE aplikacionin në kopje të shtypura dhe elektronike në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. Në rast se ndonjë dokument/dëshmi është nxjerrë në ndonjë gjuhë tjetër, aplikuesi duhet të dorëzoj dokumentin e përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të vërtetuar nga noteri.
4. Të gjithë aplikuesit për licencë, duke përfshirë aplikacionin për ndryshim, transferim apo tërheqje të një licence, duhet të paguajnë taksën administrative për rishikim të aplikacionit, në pajtim me Rregullën për Taksat.
5. Taksa e paguar nga aplikuesi për shqyrtim të aplikacionit nuk do të kthehet (rimburësohet) edhe në rastet e refuzimit të aplikacionit.

### Neni 5

#### **Procedura për shqyrtimin e aplikacioneve**

1. Procedurat e përcaktuara me këtë Rregull do të zbatohen për të gjithë aplikuesit për licencim, duke përfshirë aplikimet nga një i licencuar ekzistues për ndryshim, transferim ose përfundim të një licence aktuale.



2. ZRRE do të shqyrtoj aplikacionet bashkë me të gjitha dëshmitë e bashkangjitura dhe do ta njoftoj aplikuesin në lidhje me vendimin e saj, brenda periudhës së përcaktuar në Nenin 7 të kësaj Rregulle.
3. Nëse aplikacioni i dorëzuar konsiderohet i pakompletuar, ZRRE do të kërkoj nga aplikuesi të ofroj informatat e nevojshme shtesë për kompletim të aplikacionit, të cilat kërkohen sipas rregullave në fuqi, brenda një periudhe të specifikuar kohore.
4. Në rast se aplikacioni dhe dokumentet shtesë nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregull, ZRRE do të kërkoj nga aplikuesi të korrigjoj aplikacionin e tij brenda një periudhe kohore të specifikuar nga ZRRE. Periudha e shqyrtimit të aplikacionit do të filloj nga data kur ZRRE e konsideron aplikacionin të kompletuar.
5. Nëse aplikuesi nuk e korrigjon aplikacionin e tij/saj, ose nuk i dorëzon dëshmitë që mungojnë brenda periudhës së përcaktuar kohore, ZRRE do të refuzoj aplikacionin dhe do të informoj aplikuesin me shkrim, në përputhje me rrethanat.

#### Neni 6

##### **Publikimi i njoftimit për aplikim**

1. Pas përcaktimit nga ana e ZRRE-së se aplikacioni për licencë është i kompletuar, ZRRE do ta udhëzoj aplikuesin që të publikoj në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të madh në Kosovë një njoftim, në të cilin përshkruhet:
  - 1.1. një përmbledhje e shkurtër e aplikacionit për licencë dhe
  - 1.2. detajet për zyrtarin brenda ZRRE-së tek i cili mund të dorëzohet çdo kundërshtim lidhur me dhënien e kësaj licence. Afati i fundit për parashtrimin e çdo kundërshtimi të tillë do të jetë tetë (8) ditë punuese, nga data kur njoftimi është publikuar. Çdo kundërshtim mund të dorëzohet në formë elektronike apo ndonjë formë tjetër.
2. Nëse ZRRE pranon ndonjë kundërshtim lidhur me ndonjë aplikacion, do t'ia paraqes një kopje të tij aplikuesit dhe do ta publikoj në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.
3. ZRRE, në diskrecionin e saj, duhet të përcaktoj cilësinë e çdo kundërshtimi të tillë duke shënuar bazat ligjore për dhënien, ndryshimin, përfundimin, transferimin ose refuzimin e një aplikacioni, siq është përcaktuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
4. Aplikuesi dhe/ose ZRRE nuk do të zbulojnë asnjë informacion që konsiderohet si konfidencial, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.

#### Neni 7

##### **Forma e Aplikacionit dhe afati kohor për shqyrtimin e aplikacioneve**

1. Forma e aplikacionit për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë duhet të lëshohet dhe të publikohet nga ZRRE.



2. ZRRE duhet të marr një vendim zyrtar për secilin aplikacion brenda nëntëdhjetë (90) ditëve, pas dorëzimit të një aplikacioni të përfunduar. ZRRE duhet ta njoftoj aplikuesin në datën kur aplikacioni i tij konsiderohet i përfunduar.
3. ZRRE mund të refuzoj dhënien e një licence, në pajtim me Nenin 35 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Në rast se një licencë refuzohet, aplikuesi nuk mund të parashtroj një kërkesë të re para nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike nga data e refuzimit të aplikacionit.
4. Ofrimi i ndonjë informacioni të rremë ose mashtrues nga aplikuesi do të jetë bazë për refuzimin e aplikacionit ose, nëse një veprim i tillë zbulohet pas dhënies së licencës, atëherë kjo do të shërbej si bazë për tërheqjen e licencës, ose do të ketë sanksione të tjera të vëna nga ZRRE.

### **KREU III**

#### **KËRKESAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR APLIKIM**

Neni 8

##### **Kërkesat e përgjithshme për aplikim**

1. Secili aplikues që aplikon për licencë duhet të dorëzoj në ZRRE dokumentet si në vijim:
  - 1.1. një kopje të certifikatës së lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë, ku aplikuesit i kërkohet me ligj regjistrimi i shoqërive tregtare në Kosovë;
  - 1.2. planin biznesor të aplikuesit, lidhur me aktivitetet energjetike që do të mbulohen nga licenca, që mbulon së paku tre (3) vite.
  - 1.3. pasqyrat financiare vjetore të aplikuesit për tre (3) vitet e fundit. Këto pasqyra financiare duhet t'i nënshtrohen auditimit nga auditorë të licencuar dhe të pavarur financiarë. Aplikuesi do të dorëzoj raportin e auditorëve veçmas nga gjendja financiare, ndërsa ndërmarrja e sapokrijuar të dorëzoj deklaratën financiare dhe informacione në lidhje me përvojën e partnerëve ose aksionarëve të tij, nëse ka, në përmbushjen e aktiviteteve të ngjashme për energji;
  - 1.4 një certifikatë nga një institucion financiar ose institucione që konfirmojnë disponueshmërinë e fondeve për aktivitetin e energjisë (p.sh garanci bankare e aplikuesit ose kompanisë mëmë në rast të subvencionit, ose dëshmi të ngjashme të disponueshmërisë së fondeve të mjaftueshme për financimin e aktivitetit për të cilin kërkohet licencë.
  - 1.5 kopje të vërtetuar të regjistrimit të aksioneve ose pjesëmarrjes reale të cilitdo nga aksionarët ose partnerët e aplikuesit me dokumentet mbështetëse;
  - 1.6 kur aplikuesi ose aksionarët apo partnerët janë licencuar për kryerjen e aktiviteteve të energjisë në një shtet tjetër, licenca e tillë nuk është përfunduar, tërhequr ose pezulluar në ndonjë vend ku operon brenda pesë (5) viteve para datës së dorëzimit të aplikacionit,



ZRRE ka të drejtën të kontaktoj zyrën rregullative kombëtare të ndonjë shteti tjetër ku aplikuesi kryen ose ka kryer aktivitete të licencuara.

- 1.7. certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi në ndonjë shtet në të cilin aplikuesi kryen aktivitetet e tij, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;
  - 1.8. detajet e përvojës së aplikuesit për kryerjen e aktiviteteve të tilla të energjisë në formë të biografisë (Curriculum Vitae - CV) së ndërmarrjes;
  - 1.9. informacione në lidhje me strukturën organizative (menaxhmentin dhe personelin profesional) të aplikuesit;
  - 1.10. biografite (CV-të) e stafit menaxhues dhe personelit tjetër të lartë të aplikuesit, së bashku me kualifikimet e tyre dhe dëshmitë se menaxherët e aplikuesit nuk janë të dënuar ose të ndjekur penalisht për akte kriminale në Kosovë apo në ndonjë shtet tjetër.
  - 1.11. dëshmi për pagesën e taksës së aplikueshme për licencim (në pajtim me Nenin 4.4 të kësaj Rregulle).
2. Aplikuesi do të dorëzoj një deklaratë të nënshkruar që dëshmon se i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi në Kosovë dhe, kur aplikuesi kërkon licencë në emër të një shoqërie tregtare të sapokrijuar, në shtetin në të cilin aksionarët ose partnerët e shoqërisë së re tregtare kryejnë biznesin e tyre kryesor dhe ndonjë regjistrim të shkeljeve të mëparshme në Kosovë ose diku tjetër, lidhur me:
- 2.1. kushtet e sigurisë dhe të mbrojtjes në punë; dhe
  - 2.3. mbrojtjes së mjedisit.

#### Neni 9

#### **Kërkesat specifike të aplikimit për licensë të gjenerimit**

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licensës për prodhim të energjisë elektrike, prodhim të energjisë termike apo bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe energjisë termike, përveç kërkesave sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzoj në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
  - 1.1. të dhëna mbi stabilimentet kryesore dhe ato ndihmëse për energji, llojin dhe specifikat teknike të tyre dhe të dhëna mbi vendndodhjen e stabilimenteve energjetike;
  - 1.2. dëshmi mbi sigurimin e karburantit dhe/apo kontratën paraprake apo finale të furnizimit me karburant, aty ku është e aplikueshme;
  - 1.3. marrëveshjen për kyçje në rrjet;





- 1.4. lejen mjedisore, lëshuar nga institucioni kompetent (aty ku është e aplikueshme); gjatë periudhës së aplikimit, pëlqimi mjedisor do të jetë i mjaftueshëm;
- 1.5. planin për rehabilitim të stabilimentit (aty ku është e aplikueshme);
- 1.6. dëshmi për të drejtën pronësore të shoqëruar me skica dhe harta të pronës dhe stabilimenteve përkatëse;
- 1.7. dëshmi për efikasitet termik ( aty ku është e aplikueshme);
- 1.8. lejen për shfrytëzim të ujit (aty ku është e aplikueshme);
- 1.11. planin për dekomisionimin e njësive gjeneruese;

#### Neni 10

##### **Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit**

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për Operator të Sistemit të Transmisionit, përveç kërkesave sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzoj në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
  - 1.1. përshkrim të të gjitha sistemeve të transmisionit të poseduara dhe/ose në operim nga aplikuesi, bashkë me informatat mbi të drejtat e pronësisë për të përdorur elementet e sistemit, brenda Kosovës dhe ndonjë shteti tjetër.
  - 1.2. planin për zhvillimin e sistemit, të përcaktuar në Nenin 10 të Ligjit për Energjinë ose Nenin 18, nënparagrafi 6.1 të Ligjit për Gazin Natyror;
  - 1.3. informata rreth kapaciteteve aktuale dhe të planifikuara ndër-kufitare;
  - 1.4. dëshmi për aftësinë dhe disponueshmërinë e sistemit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm, bashkë me të gjitha burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe teknike që aplikuesi të mund t'i kryej detyrat e përcaktuara me Nenin 18 të Ligjit për Gazin Natyror dhe Nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, sipas rastit.
  - 1.5. specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse në pikat e dërgimit të energjisë elektrike; dhe
  - 1.6. deklaratën se aplikuesi do të përmbush të gjitha obligimet e tij të dala nga licenca dhe do të zhvilloj dhe do të implementoj të gjitha kodet teknike, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror.

#### Neni 11

##### **Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të Operatorit të Tregut**

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për Operator të Tregut të energjisë elektrike ose gazit natyror, përveç kërkesave të aplikueshme sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:



- 1.1. dëshmi për posedimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për komunikim me të gjitha pikat matëse, me të gjithë pjesëmarrësit e tregut, dhe
- 1.2. deklaratën se aplikuesi është i vetëdijshëm për obligimet e tij për të zhvilluar dhe zbatuar Rregullat e Tregut.

#### Neni 12

##### **Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike, përveç kërkesave të aplikueshme sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzoj në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
  - 1.1. një përshkrim të karakteristikave përkatëse të sistemit ose sistemeve të shpërndarjes, bashkë me karakteristikat e tyre teknike dhe territorin për shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike.
  - 1.2. dëshmi lidhur me pronësinë ose të drejtën ligjore për përdorimin e elementeve të sistemit;
  - 1.3. planin zhvillimor të sistemit, siç përcaktohet në Nenin 10 të Ligjit për Energjinë, Nenin 22 të Ligjit për Gazin Natyror dhe Nenin 15, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Ligjit për Energjinë Termike, varësisht sipas rastit;
  - 1.4. dëshmi lidhur me numrin e pritur dhe strukturën e konsumatorëve të kyçur dhe atyre potencial;
  - 1.5. dëshmi për aftësinë dhe disponueshmërinë e sistemit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm, bashkë me të gjitha burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe teknike që aplikuesi të mund t'i kryej detyrat e përcaktuara me Nenin 18 të Ligjit për Gazin Natyror dhe Nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, sipas rastit.
  - 1.6. treguesit për matjen e cilësisë së furnizimit me energji (kohëzgjatjen, frekuencat, numrin e ndërprerjeve, ndërprerjet e shprehura në minuta për konsumator etj.) dhe shërbimet në operimin e sistemit (informatat e përgjithshme, marrëveshjet për leximin e njehsorëve, kohën e kyçjes, dështimet, rivendosjen e sistemit energjetik pas dështimeve etj);
  - 1.7. specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse të sistemit të shpërndarjes; dhe
  - 1.8. marrëveshjen për kyçje në sistemin e transmisionit.

#### Neni 13

##### **Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të furnizimit**



1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për furnizim të konsumatorëve fundor me energji elektrike, gaz natyror dhe energji termike, përveç kërkesave sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
  - 1.1. të dhëna mbi burimet materiale në pronësi të aplikuesit, duke përfshirë të dhëna për faturimin dhe sistemin informativ, si dhe softuerin në dispozicion për kryerjen e aktiviteteve;
  - 1.2. Informata lidhur me aftësinë e trajtimit të sistemit të faturimit të aplikuesit
  - 1.3. formën(at) e kontratave që aplikuesi synon t'i përdor për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike, gaz natyror edhe energji termike;
  - 1.4. deklaratë nëse aplikuesi është i gatshëm në parim për të vepruar si Furnizues i Mundësisë së Fundit, sipas Nenit 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike ose Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike, sipas rastit, dhe nëse po, cilët numra apo kategori të konsumatorëve janë të aftë t'i trajtojnë sistemet e faturimit dhe ato administrative të aplikuesit.

#### Neni 14

#### **Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të depozitimit të gazit natyror**

1. Kërkesat për licencë për depozitimin e gazit natyror duhet të përcaktohen nga një vendim i veçantë i Bordit të ZRRE-së.

### **KREU IV**

### **TERMET DHE KUSHTET E LICENCEVE TË DHËNA**

#### Neni 15

#### **Termet dhe kushtet e përgjithshme**

1. Secila licencë, e lëshuar nga ZRRE nën termet e kësaj Rregulle, duhet të përfshij termet dhe kushtet e domosdoshme për përmbushjen e aktiviteteve të licencuara dhe vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve ndaj të licencuarve, pavarësisht nga lloji i aktiviteteve për energji.
2. Secila licencë, ndër të tjera, duhet të përmbaj dispozitat e përgjithshme si në vijim:
  - 3.1. bazën ligjore për lëshimin e licencave;
  - 3.2. llojin e aktivitetit të licencuar të energjisë;
  - 2.3. përkufizimet;
  - 2.4. kryerjen e aktiviteteve të licencuara;
  - 2.5. territorin e mbuluar nga licenca, aty ku është e aplikueshme;



- 2.6. pronësinë apo të drejtën ligjore për të shfrytëzuar territorin, stabilimentin dhe pjesët përbërëse të sistemit;
- 2.7. stabilimentet kryesore të përdorura për të kryer aktivitetet e licencuara, nëse është e aplikueshme;
- 2.8. afatet, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve;
- 2.9. kriteret për t'u përshtatur me të gjitha kodet përkatëse teknike dhe komerciale, përfshirë Rregullat e Tregut;
- 2.10. domosdoshmërinë e përputhjes me kushtet e përcaktuara në licencat e tyre, ligjet në fuqi dhe rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja;
- 2.11. dispozitat për standardet e kontabilitetit;
- 2.12 ndalimin e subvencionimit të tërthortë (ndër-subvencionimit), nëse është i aplikueshëm;
- 2.13 ndalimin e sjelljes jo-konkurrese, nëse është e aplikueshme;
- 2.14 ndalimin e diskriminimit;
- 2.15. detyrimet e shërbimit publik dhe dispozitat për furnizuesin e mundësisë së fundit, nëse është e aplikueshme;
- 2.16. integritetin dhe stabilitetin financiar të të licencuarit;
- 2.17. domosdoshmërinë e përputhjes me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë si dhe mbrojtjen e ambientit;
- 2.18. dispozitat në lidhje me përtrirjen, ndryshimin, transferimin, pezullimin, ndërprerjen dhe tërheqjen e licencës;
- 2.19. dispozitat si në ndryshimin në kontrollin e të licencuarit;
- 2.20. ndalimin rreth tjetërsimit të aseteve pa aprovimin rregullativ;
- 2.21. obligimin e mirëmbajtjes së të dhënave lidhur me aktivitetet e licencuara sipas kërkesës;
- 2.22. obligimet e sigurimit për kategori të caktuara të konsumatorëve, nëse është e aplikueshme;
- 2.23. dispozitat lidhur me raportimin në ZRRE;
- 2.24. dispozitat për pagesën e taksave;
- 2.24. dispozitat lidhur me zgjidhjen e kontesteve dhe procedurën e ankesës;
- 2.25. dispozitat ndëshkimore për shkelje të dispozitave të licencës, etj.



3. Përjashtimisht nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, ZRRE mund të përfshij në licencë edhe kushte të tjera të domosdoshme, me qëllim që të siguroj përputhshmërinë me objektivat ose kërkesat e legjislacionit në fuqi.

#### Neni 16

#### **Termet dhe kushtet e veçanta në llojet e ndryshme të licencave**

1. Në licencën për gjenerim, ZRRE mund të përfshij termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
  - 1.1. kërkesën për të ofruar matjet e duhura të ndikimit në mjedis, në përputhje me ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;
  - 1.2. rezervat e karburantit, nëse është e zbatueshme;
  - 1.3. masat e efikasitetit, nëse janë të zbatueshme;
  - 1.4. shërbimet ndihmëse dhe balancuese;
  - 1.5. dispozitat lidhur me dekomisionimin dhe/ose heqjen e të gjitha ndërtimeve dhe strukturave dhe kthimin e tokës në gjendjen origjinale, nëse është e zbatueshme;
2. Në licencën për **Operator të Sistemit të Transmisionit**, ZRRE mund të përfshij edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
  - 2.1. kërkesën që të siguroj kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit të transmisionit nga palët e treta që kërkojnë aranzhimin e bartjes së energjisë elektrike, gazit natyror ose energjisë termike në një mënyrë jo-diskriminuese, me dispozitat e duhura që drejtojnë dorëzimin e kërkesave për qasje dhe procedurat për mohimin e qasjes, si dhe procedura e apelimit nga palët që iu është mohuar qasja;
  - 2.2. kërkesat lidhur me certifikimin e OST-së që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të dëshmuar se është i përshtatshëm për t'u certifikuar si OST, nën dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Gazin Natyror;
  - 2.3. në rastin e energjisë elektrike, prioritet i dispeçimit dhe kyqjes së energjisë së gjeneruar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, të përcaktuara në Nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë, Nenin 16, nënparagrafi 1.44 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Neni 14.2 të Ligjit për Energjinë Termike, si dhe rregulla dhe kode të tjera të zbatueshme në sektorin e energjisë;
  - 2.4. obligimin që të publikohen informatat rreth planit të mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit dhe interkonesionit dhe kongestionet e mundshme, në përputhje me ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi.
  - 2.5. obligimin për të përgatitur dhe azhurnuar planin zhvillimor dhe të investimeve për sistemin e transmisionit, në përputhje me ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;



- 2.6. detyrimin për mirëmbajtjen e bazës së shënimeve të informatave të pranuar nga shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, që përmban të dhëna të hapura për publikun, në baza të grumbulluara, në të njëjtën kohë duke ruajtur të dhënat e konsideruara konfidenciale dhe komercialisht të ndjeshme;
  - 2.7. aty ku është e zbatueshme, krijimin e një programi të përputhshmërisë lidhur me kërkesat e shturjes, i cili përcakton masat e marra për të parandaluar sjelljet diskriminuese të pjesëmarrësve në treg dhe për të siguruar monitorimin adekuat të tij;
  - 2.8. detyrimin për të zhvilluar kodet teknike, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror, dhe t'i modifikoj ata në konsultim me përdoruesit;
  - 2.9. reduktimin e humbjeve teknike në sistemin e transmisionit;
  - 2.10. instalimin e pajisjeve matëse të duhura dhe të mjaftueshme për t'i lejuar operatorit që të ofroj të dhëna të sakta tek ZRRE, shfrytëzuesit e sistemit ose persona të tjerë të interesuar lidhur me energjinë e pranuar ose të dalur nga sistemi i tij.
  - 2.11. përgjegjësitë lidhur me interkoneksionet dhe mekanizimin kompensues ndër -OST
  - 2.12. përgjegjësi të tjera të operatorit të sistemit të transmisionit, siq janë përcaktuar në ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;
3. Në Licencën e **Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**, ZRRE mund të përfshij termet dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
    - 3.1 kërkesën që të sigurojë kyçjen dhe shfrytëzimin e e sistemit të shpërndarjes nga palët e treta që kërkojnë aranzhimin e barjes së energjisë elektrike, gazit natyror ose energjisë termike në një mënyrë objektive dhe jo-diskriminuese; me dispozitat e duhura që administrojnë dorëzimin e kërkesave për qasje, procedurën për refuzimin e qasjes dhe procedurën e apelimit nga palët të cilave iu është mohuar qasja.
    - 3.2 në rastin e energjisë elektrike, prioritet i dispeçimit dhe kyqjes së energjisë së gjeneruar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, siq është përcaktuar në Nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë, Nenin 16, nënparagrafi 1.44 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Neni 16.6 të Ligjit për Energjinë Termike, si dhe rregulla dhe kode të tjera të zbatueshme në sektorin e energjisë;
    - 3.3 obligimin për të përgatitur dhe azhurnuar planin zhvillimor dhe të investimeve për sistemin e shpërndarjes, në konsultim me operatorin e sistemit të transmisionit, në përputhje me ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;
    - 3.4 detyrimin për mirëmbajtjen e bazës së shënimeve të informatave të pranuar nga shfrytëzuesit e sistemit të shpërndarjes, që përmban të dhëna të hapura për publikun, në baza të grumbulluara, në të njëjtën kohë duke ruajtur të dhënat e konsideruara konfidenciale dhe komercialisht të ndjeshme;
    - 3.5 themelimin e një programi të pajtueshmërisë lidhur me kërkesat e shturjes, në pajtim me ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë që përcakton masat e marra



për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese nga pjesëmarrësit në treg dhe të siguroj që zbatimi i tij është monitoruar në mënyrë adekuate;

3.6 obligimin për zhvillimin e kodeve teknike, të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror, dhe t'i modifikoj ato në konsultim me përdoruesit;

3.7 të gjitha kërkesat për matje dhe faturim janë përcaktuar dhe kryhen në një mënyrë të sigurt dhe ekonomike për të siguruar që edhe përdoruesit e sistemit edhe konsumatorët e kyqur në sistem mund të pranojnë të dhëna të përditësuara për kërkesën dhe konsumin;

3.8 Reduktimin e humbjeve në sistemin e shprëndarjes;

3.9 instalimin e pajisjeve matëse të duhura dhe të mjaftueshme për t'i lejuar operatorit që t'u ofroj të dhëna të sakta ZRREsë, shfrytëzuesve të sistemit ose personave të tjerë të interesuar lidhur me energjinë e pranuar ose të dalur nga sistemi i tij;

3.10 përgjegjësi të tjera të Operatorit të Sistemit të Shprëndarjes, siq janë përcaktuar në ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë.

4. Në Licencën për **Furnizim Publik** të energjisë termike, ZRRE mund të përfshij termet dhe kushtet që kanë të bëjnë me:

4.1. kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Energjinë Termike që kanë të bëjnë me furnizim publik të ngrohjes tek konsumatorët;

4.2. dispozitat në lidhje me Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, në mënyrë që të siguroj vazhdimësinë e furnizimit të konsumatorëve me energji termike;

4.3. kërkesat për blerjen e stabilimenteve dhe pajisjeve në një mënyrë që është ekonomike dhe efikase;

4.4. kërkesat për të siguruar që mbajtësi i licencës do t'i informoj të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të drejtën e ankesës për dëmtime, si dhe themelon procedurat e duhura për shqyrtimin e ankesave të tilla dhe kompensimit, dhe

4.5. parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve për konsumatorë.

4.6. Përgjegjësi të tjera të përshkruara në ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;

5. Në licencën për **furnizim me energji elektrike dhe gaz natyror**, ZRRE mund të përfshij edhe termet dhe kushtet që kanë të bëjnë me:

5.1. kërkesat e përcaktuara në ligjet, rregullat dhe kodet në fuqi në sektorin e energjisë;

5.2. obligimin për blerjen e energjisë në mënyrën më efikase dhe ekonomike, nëse ka të bëjë me furnizuesin e shërbimit universal ose furnizuesin e mundësisë së fundit;



- 5.3. obligimin për t'i informuar të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të drejtën e ankesës për dëmtime, si dhe themelimin e procedurave të duhura për shqyrtimin e ankesave të tilla dhe kompensimit;
  - 5.4. parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve për konsumatorë;
  - 5.5. parandalimin e praktikave jo-konkurruese;
  - 5.6. çdo obligim të shërbimit publik, varësisht si është e zbatueshme;
6. Në licencën për **Operator të Tregut**, ZRRE mund të përfshij termet dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
- 6.1 kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror;
  - 6.2. obligimin për të zhvilluar Rregullat e Tregut, siq është përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror dhe t'i modifikoj ato në konsultim me shfrytëzuesit;
  - 6.3. ofrimin e informatave të sakta dhe të besueshme tek pjesëmarrësit në treg lidhur me çmimet, numrin e pjesëmarrësve në treg, përqindjen e aksioneve në treg, çmimet e parashikuara dhe statistikat e pjesëmarrësve në treg;

## **KREU V MONITORIMI**

### Neni 17

#### **Monitorimi i aktiviteteve të licencuara**

1. ZRRE duhet të monitoroj performancën e aktiviteteve të licencuara bazuar në të dhënat e dorëzuara nga i licencuari dhe informatat nga tregu, sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.
2. I licencuari duhet të bashkëpunoj me ZRRE-në në ofrimin e të gjitha të dhënave të kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.
3. ZRRE mund të kryej inspektime fizike të objekteve dhe dokumenteve të lidhura me licensën në stabilimentet e të licencuarit (vizita periodike të paralajmëruara ose të pa paralajmëruara) ose në përputhje me Nenin 33, paragrafin 3 të Ligjit për Energjinë, kërkesën nga Inspektoriati i Ministrisë përkatëse të Energjisë për të performuar inspektimet e tilla në stabilimentet e ndërmarrjeve të licencuara dhe duhet t'i ofroj ZRRE-së një raport të shkruar për inspektimin

### Neni 18

#### **Obligimet për mbajtjen dhe mbledhjen e informatave nga i licencuari**





1. ZRRE mund t'i kërkoj të licencuarit të mbledh dhe të mbaj informata, të dhëna dhe dokumente lidhur me konsumatorët, pajisjet matëse, të dhëna lidhur me matjen e cilësisë së furnizimit dhe numrin e ankesave, duke përfshirë të dhënat për:

1.1 emrat dhe adresat e konsumatorëve;

1.2 lokacionin e pajisjeve matëse;

1.3 shumat e kompensimit të paguara tek konsumatorët në rast të performancës së dobët, nëse ka ndonjë;

1.4 numrin e kontratave të nënshkuara nga kategoritë e ndryshme të konsumatorëve fundor;

1.5 numrin dhe llojin e ankesave të regjistruara; dhe

1.6 të dhëna të tjera shtesë, varësisht si ZRRE e sheh të nevojshme.

## **KREU VI VAZHDIMI, MODIFIKIMI, PEZULLIMI, TRANSFERIMI DHE NDËRPRERJA E LICENCËS**

Neni 19

### **Vazhdimi i licencës**

1. ZRRE mund të vazhdoj kohëzgjatjen e një licence për një periudhë tjetër, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me kusht që i licencuari të plotësoj të gjitha detyrimet dhe kërkesat e përshkuara në licencën e tij dhe të ketë dorëzuar një aplikacion me shkrim për vazhdim.
2. Aplikimi për vazhdim të licencës për aktivitetet e përcaktuara në licencë do të bëhet jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës, siç përcaktohet në Nenin 20, paragrafi 3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
3. Çdo kërkesë për vazhdim të licencës do të trajtohet nga ZRRE në përputhje me procedurën për aplikim për licencë, të përcaktuar në këtë Rregull.
4. Vazhdimi do të filloj prej datës së skadimit të periudhës së vlefshmërisë së licencës.
5. Formulari i aplikimit për vazhdim të licencës duhet të hartohet dhe publikohet nga ZRRE-ja.

Neni 20

### **Modifikimi/ndryshimi i licencës**



1. Licencat mund të modifikohen me iniciativë të ZRRE-së, në diskrecionin e saj të plotë, por duke marrë parasysh komentet e pranuar nga i Licencuari dhe palët e tjera të interesuara pas konsultimit të hapur.
2. Për çdo modifikim të licencës, ZRRE duhet të informoj të licencuarin me shkrim. Njoftimi duhet të specifikoj bazën e modifikimit të propozuar dhe rezultatet e pritura nga ai.
3. Brenda një periudhe prej katërmbëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të njoftimit, në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, i Licencuari mund të mbush një deklaratë me shkrim duke prezantuar pikëpamjet e tij lidhur me njoftimin nga ZRRE për modifikim të licencës, dhe duhet të bashkëngjis çdo dokument tjetër mbështetës.
4. Pas modifikimit të propozuar, ZRRE duhet të konsultohet me të gjithë të licencuarit dhe palët e tjera të interesuara.

#### Neni 21

##### **Modifikimi i licencës me kërkesë të të licencuarit**

1. I licencuari mund të kërkoj modifikimin e licencës së tij në çdo kohë.
2. I licencuari do të dorëzoj të gjithë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për të mbështetur kërkesën për modifikim të licencës.
3. Modifikimi i licencës, me kërkesën e të licencuarit, i nënshtrohet vendimit të ZRRE-së dhe përgjigjeve të pranuar pas konsultimit më të licencuarit dhe palët e tjera të interesuara..
4. Forma e aplikacionit për modifikim të licencës hartohet dhe publikohet nga ZRRE-ja.

#### Neni 22

##### **Pezullimi i licencës**

ZRRE mund të pezulloj përkohësisht licencën në rastet kur pezullimi arsyetohet. Në këtë rast, të licencuarit i jepet koha e arsyeshme për të korrigjuar veprimin e tij apo mosveprimin, si dhe kur i licencuari dëshmon aftësi dhe gatishmëri për të bërë një korrigjim të tillë.

#### Neni 23

##### **Ndërprerja e licencës**

1. Në pajtim me Nenin 37 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, çdo licencë e lëshuar mund të ndërpritet apo të tërhiqet nga ZRRE në rastet si në vijim:
  - 1.1. me skadimin e afatit të vlefshmërisë, përfshirë zgjatjet e mundshme të afatit të saj;
  - 1.2. me kërkesë të të licencuarit, me kusht që detyrimet e të licencuarit të merren përsipër nga i licencuari tjetër, apo që konsumatorët të mos humbin nga kjo ndërprerje e licencës;



- 1.3 me revokimin e saj nga ZRRE,
- 1.4 me shpërbërjen e personit juridik që është bartës i licencës;
- 1.5 shkatërrimin e stabilimentit të energjisë me pamundësi riparimi;
- 1.6. nëse aktiviteti i licencuar për energji nuk është kryer për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç nëse kjo është bërë me aprovimin e ZRRE-së;
- 1.7. nëse janë plotësuar dispozitat e Nenit 25 të kësaj Rregulle;
- 1.8 nëse i licencuari nuk i përmbush ose nëse i shkel kushtet detyrimet thelbësore të përcaktuara me licencë dhe nuk korrigjon dështimet e tilla brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
- 1.9 nëse aktivitetet e të licencuarit ndërpriten si rezultat i deklaramit të paaftësisë për të paguar apo likuidimit, megjithatë, ky nënparagraf nuk zbatohet për një proces të riorganizimit i cili mbikëqyret nga gjykata nëse i licencuari vazhdon veprimtarinë e tij gjatë këtij procesi; si dhe
- 1.10 nëse i licencuari ka dorëzuar informacione jo të sakta që janë marrë si bazë për dhënien e licencës, si dhe kur informatat e tilla kanë rëndësi të madhe për kryerjen e mirëfilltë të aktiviteteve të licencuara:
  2. Në lidhje me paragrafin 1, një licencë mund të ndërpritet vetëm nëse ZRRE konstaton se detyrimet e të licencuarit, përfshirë obligimet e shërbimit publik, mund të kryhen në mënyrë të kënaqshme nga një i licencuar tjetër ose kur konsumatorët nuk pësojnë nga ndërprerja e një licence të tillë.
  3. Çdo kërkesë për ndërprerje ose tërheqje të licencës do të trajtohet nga ZRRE-ja në përputhje me procedurën për aplikim për licencë, të përcaktuar në këtë Rregull.

#### Neni 38

#### **Transferimi i licencës së ndërprerë**

1. Kur një licencë e dhënë një të licencuari nga ZRRE është ndërprerë, ZRRE, në diskrecionin e saj të plotë, mund të transferoj këtë licencë tek një person tjetër, në përputhje me Nenin 37.4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Licenca do të transferohet nga ZRRE vetëm në rast se arsyet për këtë transferim janë të justifikuar nga aplikuesi, si dhe:
  - 2.1. nëse marrësi i propozuar do të pranoj t'i kryej detyrimet e mbetura të të licencuarit aktual, qoftë sipas licencës së të licencuarit aktual, kësaj rregulle, apo edhe sipas legjislacionit në fuqi; dhe
  - 2.2. nëse marrësi i propozuar përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë Rregull për Licencim dhe në legjislacionin në fuqi; dhe



- 2.3. i licencuari plotëson të gjitha kërkesat e pranueshmërisë që do të duhet të përmbusheshin nëse ai do të aplikonte për marrjen e licencës
3. Procedura e transferimit kryhet nga ZRRE në të njëjtën mënyrë si për dhënien e licencës. ZRRE do të përcaktoj nëse marrësi i propozuar është i aftë për të përmbushur kushtet e licencës. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës dhe përmbajtja e licencës do të mbeten të njëjta.
4. Forma e aplikacionit për transferim të licencës do të hartohet dhe publikohet nga ZRRE.

#### Neni 25

#### **Pezullimi ose ndërprerja e licencës lidhur me mbylljen e stabilimentit të licencuar për gjenerim**

1. Para ndërprerjes së licencës, sipas Nenit 23 të kësaj Rregulle, ZRRE, me vetë-iniciativë ose me kërkesë të të licencuarit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe autoritete të tjera relevante, duhet të aprovoj:
  - 1.1 pezullimin e licencës për gjenerim të energjisë elektrike dhe energjisë termike për një periudhë të shkurtër kohorë;
  - 1.2 mbylljen e stabilimentit të energjisë, subjekt i kërkesave se një garancion financiar është depozituar në banke mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet;
  - 1.3 mosvazhdimësia dhe dekomisionimi i gjenerimit të energjisë dhe mbyllja e plotë e impiantit gjenerues
2. Sipas Nenit 19 të kësaj Rregulle, licenca mund të zgjatet nëse kjo zgjatje kërkohet për të lehtësuar tërheqjen e aktivitetit të licencuar ose në interes të sigurisë së furnizimit.
3. Licenca mund të ndërpritet vetëm nëse ZRRE ka vendosur që obligimet e të licencuarit, duke përfshirë obligimet e shërbimit publik, mund të kryhen në mënyrë të kënaqshme nga një i licencuar tjetër ose kur konsumatorët nuk pësojnë nga përfundimi i një licence të tillë.
4. ZRRE mund të transferoj licencën, e cila është përfunduar, tek një i licencuar tjetër, me kusht që i licencuari i ri të aplikoj për licencë dhe ajo t'i jetë aprovuar.
5. Çdo kërkesë për ndërprerje ose tërheqje të licencës duhet të trajtohet nga ZRRE, në pajtim me procedurat e aplikimit për licencë, të përcaktuara në këtë Rregull.

## **KREU VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 26 Gjuha zyrtare



Kjo Rregull është nxjerr në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.

Neni 27  
**Ndryshimi**

1. ZRRE ka të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj këtë Rregull, në çdo kohë.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.
3. Modifikimi i kësaj Rregulle nuk ndikon vlefshmërinë e ndonjë licencë të lëshuar nga ZRRE në kuadër të ndonjë versioni të mëparshëm të kësaj Rregulle.

Neni 28  
**Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerr informacione shpjeguese.

Neni 29  
**Shfuqizimi**

Kjo Rregull shfuqizon Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, të nxjerr në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë no. 05/L-084 dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 29.08.2011.

Neni 48  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:**

\_\_\_\_\_  
, Kryesues

\_\_\_\_\_  
, Anëtar

\_\_\_\_\_  
Anëtar